



BULETIN JAVOR

13-17 MAJ 2024



PËRMBAJTJA

- Western Balkans Cyber Camp 2024
- AKSK trajnon studentët e Universiteteve pranë One Albania
- Pjesëmarrës në Konferencën Ndërkombëtare për Sigurinë Kibernetike RSAC 2024
- Një Cyber Drill i Suksesshëm Falë Ekspertëve Të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike

Western Balkans Cyber Camp 2024



Aktiviteti Western Balkans Cyber Camp in Albania, organizuar më 10-12 Maj në Durrës, ku morën pjesë 48 të rinj nga ekonomitë e Ballkanit Perëndimor të shoqëruar nga profesorë dhe ekspertë të CSIRT-eve kombëtare, u përmbyll me sukses. Aktiviteti u hap me fjalë përshëndetëse nga Drejtori i Përgjithshëm i AKSK, Z. Igli Tafa, Kryetarja në detyrë e

Departamentit të Programeve pranë Këshillit për Bashkëpunim Rajonal(RCC) Znj. Pranvera Kastrati, Përgjegjësjë e Zyrës Politike/Ekonomike pranë Ambasadës Amerikane në Tiranë Znj. Allison Dyess, Këshilltarja për Sigurinë në Komunitet pranë Prezencës së OSBE në Shqipëri, Znj. Brunilda Halili dhe Drejtuesi i Programeve për Qendrueshmëri Kibernetike dhe Digjitale pranë CRDF Global, Z. Todd Spires.

Ky event u organizua nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Misioneve të OSBE në Serbi, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC), Departamentit Amerikan të Shtetit dhe CRDF Global.

AKSK trajnon studentët e Universiteteve pranë One Albania

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) zhvilloi në datë 14 Maj pranë ambienteve të kompanisë One Albania trajnim me studentë praktikantë nga Universitete të ndryshme. Ky trajnim u udhëhoq nga ekspertë të Autoritetit ku u diskutuan tematikat mbi:

- Sigurinë Kibernetike
- Menaxhimin e një incidenti kibernetik ku u shpjeguan se cilat janë hapat që ndërmerren gjatë menaxhimit të një incidenti kibernetik
- Pjesa praktike (Cyber Drill Exercise) ku u krye një simulim i rasteve të një incidenti kibernetik

Qëllimi i këtij trajnimi është rritja e kapaciteteve të studentëve dhe aftësimi i tyre në fushën e sigurisë kibernetike.





Pjesëmarrës në Konferencën Ndërkombëtare për Sigurinë Kibernetike RSAC 2024



Në datat 6-9 Maj në San Francisco, Kaliforni u organizua Konferenca RSAC 2024, në të cilën morën pjesë 40 000 ekspertë të sigurisë kibernetike nga e gjithë bota dhe rreth 500 kompani në fushën e sigurisë kibernetike dhe teknologjisë së informacionit.

Në kuadër të kësaj konference u mbajt edhe takimi i II i Forumit Ndërkombëtar të Sigurisë Kibernetike ICSF, i cili bashkoi mbi 70 delegatë qeveritarë nga më shumë se 35 vende dhe organizata ndërkombëtare për të diskutuar mbi rreziqet dhe çështjet më urgjente të sigurisë kibernetike që po përballen shtetet. AKSK në këtë takim u përfaqësua nga Drejtori i Drejtorisë së Qeverisjes Kibernetike, Riskut dhe Kontrollit, Z. Saimir Kapllani i cili ndau me të pranishmit hapat e ndërmarrë nga Shqipëria për përballimin e sulmeve kibernetike si dhe sfidat me të cilat po përballen vendi ynë.

Për herë të parë në histori, ky forum u përshëndet nga Sekretari Amerikan i Shtetit Z. Antony Blinken, i cili në fjalën e tij theksoi rëndësinë e solidaritetit digjital dhe bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik dhe privat për të krijuar një ekosistem kibernetik të qëndrueshëm dhe të sigurt.

"Qëndrimi krah për krah me partnerët dhe aleatët për të avancuar në një vizion të përbashkët për një ekosistem teknologjik që respekton të drejtat, inovativ dhe të sigurt është një domosdoshmëri bazë" theksoi Sekretari i Shtetit.

Gjatë ditëve të aktivitetit Z. Kapllani realizoi takime me drejtues të agjencive të sigurisë kibernetike të shteteve të ndryshme, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, operatorë ekonomik si dhe me Z. Eric Goldstein, asistent i Drejtorit Ekzekutiv të CISA. Gjatë takimit me këtë të fundit u diskutua për rritjen e bashkëpunimit midis dy institucioneve në kuadër të ndarjes së informacioneve për kërcënimet kibernetike, asistencë për menaxhimin e incidenteve si dhe rritjen e kapaciteteve me qëllim mbrojtjen e infrastrukturave kritike.

Një Cyber Drill i Suksesshëm Falë Ekspertëve Të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike

Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike gjen rastin të falenderojë ekspertët Erand Elmazi, Gerald Bici, Ergis Gaxho, Enxhi Mete, Adriano Lleshi, Redon Hoxha, Bledar Kacadej, Kristian Josifi dhe Franc Zylyftari për një Cyber Drill tepër të suksesshëm!

Përfshirja dhe entuziazmi i të rinjve ishte jashtëzakonisht frymëzues. Faleminderit për kontributin tuaj në nxitjen e dijes dhe ndërtimin e një mjedisi të sigurt kibernetik.

